



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE
PËR VITIN 2021**

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KPMM kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori Menaxhues është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Menaxhues është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur se menaxhimi i shpenzimeve ka nevojë për përmirësim. Gjetja dhe rekomandimi kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'a përcjellim (shqyrtojmë) këtë rekomandim gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 3 rekomandime të reja.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 720.134€. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 100%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 76 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 67 (përfshirë edhe anëtarët e Bordit). Gjatë vitit 2021 është punësuar një zyrtarë. Kemi testuar 23 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 20,539€.

Çështja A1 - Mosrespektimi i vendimit për shtesat e stafit

- Gjetja** Me datë 14.01.2009 KPMM - Bordi Qeveris kishte marr vendim mbi aprovimin e propozimit të shtesave në angazhimin e shtuar në punë për stafin e KPMM duke pas për qëllim kryesor rritjen e efikasiteti në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi ligjore të KPMM-së. Kjo duke i bazuar në specifikat e punës, rrezikshmërinë në kryerjen e punës, performancën në punë. Bordi ka aprovuar shtesat në pagë për stafin e KPMM, efektive nga datë 01.02.2009.
- Në një rast është identifikuar se kjo shtesë nuk përputhet me këtë vendim (Zyrtar i lartë i Financave dhe Pasurisë shtesat 200€ edhe pse i njëjti zyrtar mban dy pozitat shtesa në vendim janë paraparë për këto pozita ndaras apo vetëm 150€).
- Kjo për shkak se vendimi nuk ishte azhurnuar nga Bordi bazuar në nevojat për organizimin dhe strukturimin e stafit të zhvilluar pas fuqizimit të këtij vendimi, shkurtit të vitit 2009.
- Ndikimi** Mos harmonizimi i vendimit nga 2009 me nevojat dhe zhvillimet brenda KPMM, ka rezultuar me aplikimin e parregullt të shtesave, i cili tejkalon kompetencën e aprovimit të këtyre shtesave nga nivelet relevante, Bordi.
- Rekomandimi A1** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se aplikimi i shtesave bazohet në vendimin në fuqi, dhe i njëjti vendim duhet të përditësohet bazuar në strukturën aktuale të stafit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në dosjen e personelit

- Gjetja** Sipas vendimit Nr. 06/29 datë 15.05.2015 përkatësisht pikës 6 Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në çdo institucion, në pajtim me këtë vendim, vendos për njohjen e përvojës së punës së një nëpunësi i cili realizon pagë nga buxheti i Kosovës. Vendimi i përvojës së punës bëhet pjesë e dosjes së personelit për secilin nëpunës dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.
- Nga 17 rastet e audituara (17 dosje të personelit), dëshmitë e përvojës së punës nuk ishin përmbledhur me një vendim të përvojës së punës i cili bëhet pjesë e dosjes së personelit për secilin nëpunës dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi sipas pikës 6 të vendimit të Qeverisë me nr. 06/29.

Sipas zyrës së personelit lista është përgatitur për të gjithë stafin bazuar në dëshmitë e përvojës dhe e njëjta është përcjellë tek MAP, mirëpo vendimet individuale për stafin nuk ishin përgatitur.

Ndikimi

Mungesa e një vendimi nga njësia përgjegjëse e personelit rezulton me kontrole jo adekuate për shkak se me zbatimin e kësaj procedure zyra e personelit siguron se dëshmitë janë kontrolluar paraprakisht dhe janë relevante, të pranuar dhe të përmbledhura brenda një akti administrativ i cili shërben si bazë për pagesën e shtesës së përvojës.

Rekomandimi A2

Bordit i KPMM-së duhet të siguroj se kërkesat bazuar në vendimin e Qeverisë implementohen nga nivelet relevante, zyra e personelit, e cila vendos njohjen e përvojës bazuar në një vendim, i cili duhet ti bashkëngjitet dosjes së personelit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 269,201€, pasurive jokapitale është 53.263€, si dhe e stoqeve 12,186€. Kemi testuar 19 mostra për teste substanciale në vlerë 126,970€, gjithashtu kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë për procedura.

Çështja A3 - Mos-zhvlërësimi i pasurisë jo kapitale nën 1,000€

Gjetja Sipas rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare neni 22 pika 3 3. Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlërësimit. Gjithashtu, neni 24 pika 3 thot që paraqitja e pasurisë jo financiare në Pasqyrat financiare vjetore do të prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto.

Të pasuritë jo kapitale (nën 1000 euro) për vitin 2021 nuk ishte kalkuluar zhvlërësimi. Edhe pse kjo gjendje ishte shpalosur në shënimet e PVF-ve, pasuritë jo kapitale ishin pasqyruar në PVF me vlerën bruto të tyre. Më tej, KPMM nuk ka informata të sakta për vlerën e zhvlërësimit të këtyre pasurive për vitin 2021.

Mos kalkulimi i shpenzimeve të zhvlërësimit ishte rezultat i problemeve me sistemin E pasuria. Sipas zyrtarëve në KPMM, këtë proces nuk e kanë kryer zyrtarët përgjegjës të MAP-it, në sistemin e-Pasuria, me arsyetimin se nuk kanë kontratë me ndonjë operator për mirëmbajtjen e sistemit e-Pasuria.

Ndikimi Mos zhvlërësimi i pasurive ka ndikuar në mbivlerësimin e tyre dhe në prezantim jo të drejtë të gjendjes së pasurive në pasqyrat vjetore financiare.

Rekomandimi A3 Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmerr masa të duhura për eliminimin e pengesave në menaxhimin e pasurive, në mënyrë që të siguroj raportim të drejtë të gjendjes së tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,338,992	1,220,728	1,198,673	1,126,488	1,265,209
Grante Qeveritare - Buxheti	1,338,992	1,220,728	1,198,673	1,126,488	1,205,209
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	60,000

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 118,264€. Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 106,570€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë nr.11/52 të datës 29.12.2021. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 100%.

Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 11,694€ me vendim të Qeverisë nr.21/50 datë 23.12.2021 për kursime dhe ndarje në kategoritë e shpenzimeve në organizatat buxhetore. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e shërbimeve komunale ishte 84%.

Në vitin 2021 KPMM ka shpenzuar 1,198,673€ (98% të buxhetit përfundimtar), me një përmirësim rreth 6% në krahasim me vitin 2020.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,338,992	1,220,728	1,198,673	1,126,488	1,265,209
Pagat dhe mëditjet	826,705	720,135	720,135	771,181	792,642
Mallrat dhe shërbimet	331,687	331,687	320,599	306,723	375,849
Komunalitë	30,600	18,906	15,926	15,334	27,812
Investimet Kapitale	150,000	150,000	142,014	33,250	68,906


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 106,570€.

Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë nr.11/52 të datës 29.12.2021. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 100%.

Buxheti final për komunalitet krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 11,694€ me vendim të Qeverisë nr.21/50 datë 23.12.2021. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e shërbimeve komunale ishte 84%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara për vitin 2021 ishin 20,029,887€ Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga: Taksa Administrative, Gjoha Administrative dhe nga Renta Minerare.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	16,355,667	20,870,796	20,029,887	29,968,212	30,448,800
Të hyrat jo tatimore - renta minerare	15,700,000	20,000,000	19,235,177	29,362,288	29,385,154
Të hyrat jo tatimore taksa ngarkesa tjera	655,667	870,796	794,710	605,924	1,063,645

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 të KPMM-së ka rezultuar me dy (2) rekomandime. KPMM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku ka prezantuar mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna duke përfshirë personat përgjegjës dhe afatet kohore për secilin rekomandim.

Menaxhmenti i KPMM-së ka ndërmarrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura, ku deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, të dy (2) rekomandimet ishin zbatuar, Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni më poshtë Tabelën e rekomandimeve.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se paratë publike të destinuara për menaxhim të pandemisë shpenzohen në përputhje me nevojat reale të OB-së dhe në harmoni me kërkesat e legjislacionit në fuqi.	Menaxhmenti i KPMM-së kishte ndërmarrë veprime për zbatimin e rekomandimit.	I zbatuar
2.	Obligimet e papaguara	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se pagesa e obligimeve të bëhet brenda afateve të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.	Menaxhmenti i KPMM-së kishte ndërmarrë veprime për zbatimin e rekomandimit.	I zbatuar


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm




Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Valbona Tolaj, Udhëheqëse e ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmëriat me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT / NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
11.08.2022			
Titulli / Title / Долг. долж.	Shitësit / Class / Класа	Nr. Prot. / Prot. No.	Emri / Name / Имя
05	47	983	L

Zaj. Selvetë Grajqevci – Pllana

[Signature]

Kryesuese e Bordit të KPMM-së

Data: 13 Qershor 2022, Prishtinë



2076

13/06/22

Str. Prizreni Durrës 50-1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 249 252
Fax: +383 (0) 245 814
E-mail: ICMM@kmmrsmm.org
Web: www.kmmrsmm.org

Enverë Hoxhë
Shtetëtarë Kosovë
Assembly of Kosovo

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.